



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0428

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " INFINITT " SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “96 Mirëmbajtja e institucioneve vartëse dhe hapësirave për art dhe kulturë” me numër të prokurimit 616-26-2525-2-2-1, me 03/08/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE " INFINITT " SH.P.K. me nr. 2026/0428 , e datës 26/06/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “96 Mirëmbajtja e institucioneve vartëse dhe hapësirave për art dhe kulturë” me numër të prokurimit 616-26-2525-2-2-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, ndërkaj aktiviteti i prokurimit “96 Mirëmbajtja e institucioneve vartëse dhe hapësirave për art dhe kulturë” me numër të prokurimit 616-26-2525-2-2-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik " INFINITT " SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 21.04.2026. KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Ftesën për ofertim, për aktivitetin e prokurimit “96 Mirembajtja e institucioneve vartese dhe hapesirave per art dhe kulture” me nr. të prokurimit: "616-26-2525-2-2-1"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: sherbim, vlera e parashikuar e kontrates per lot.3 : 1,769.99 €.

Me 09.06.20206. KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), kunder njoftimit për dhënie të kontrates ku është rekomanduar për kontratë " Migrant Ing " SH.P.K.

Me 15.06.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 18.06.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 26.06.2026, OE INFINITT " SH.P.K." ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0361, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder njoftimit për dhenje të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues INFINITT " SH.P.K." janë parashtruar si në vijim:

Neni 1 - Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi

Neni 52.3 - Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

Neni 54 - Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar

Neni 56.3 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Neni 59 - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

Neni 60 - Kriteret për dhënie të kontratës

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve / pika 2

AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë - LOT 3 nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht dispozitat ligjore të lartcekura dhe Udhëzimin Operativ e Rregulloren për Prokurim Publik.

AK/Zyra e Prokurimit më 09.06.2026 ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar për kontratë në LOT 3 OE MEGRANT ING SH.P.K.

Për këtë LOT, oferta e kompanisë sonë ka qenë më e ulët se çmimi i OE të rekomanduar për kontratë.

Pasiqë AK na është drejtuar me letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm e jo tenderuesin e eliminuar, citoj:

"Oferta juaj është vlerësuar si ofertë e përgjegjshme në përputhje me kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjen e tenderit, por është e pasuksesshme për shkak se keni ofruar çmim më të lartë, me çmim prej 1575.00 euro."

Ky konstatim i AK/Komisionit vlerësues nuk qëndron. Oferta e kompanisë sonë është 1575.00 euro, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë në LOT 3 është 1760.00 euro.

AK në nenin 2.5 të FDT-së ka cekur se numri maksimal i pjesëve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues është: 2, prandaj kemi kërkuar nga Zyra e Prokurimit që ta kthejë lëndën në rivlerësim edhe për LOT 3 dhe të rekomandohet për kontratë kompania jonë, konform nenit 60 të LPP-së, si oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët.

Ne, më 10.06., i jemi drejtuar me email Zyrës së Prokurimit duke kërkuar sqarim pse nuk jemi rekomanduar për kontratë në LOT 3, pasi që AK na është drejtuar me letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm e jo tenderuesin e eliminuar, mirëpo nuk kemi pranuar përgjigje nga Zyra e Prokurimit, prandaj jemi detyruar të parashetrojmë kërkesë për rishqyrtim.

Në përgjigje/refuzim të kërkesës për rishqyrtim është cekur:

"Është gjetur se arsyet e evidentuara nga Komisioni vlerësues në letrën standarde janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë."

Ky konstatim në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim bie në kundërshtim me njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues, ku AK na është drejtuar me letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm e jo tenderuesin e eliminuar.

Shkelje tjetër procedurale në këtë aktivitet të prokurimit është se AK nuk ka pezulluar aktivitetin e prokurimit konform pikës 2 të nenit 108/A të LPP-së pas dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim, por ka vazhduar me dhënie dhe më 24.06. është publikuar njoftimi për dhënie të kontratës për LOT 3.

Marrë parasysh faktet e lartcekura, konstatohet se AK/Komisioni vlerësues jashtëligjshëm ka rekomanduar për kontratë OE Migrant Ing SH.P.K. për LOT 3, megjithëse oferta e kompanisë sonë ka qenë me çmim më të ulët edhe në këtë LOT.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori ekonomik "INFINITI shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 15.06.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me akuviteun e prokurimit me titull "96 Mirëmbajtja e institucioneve vartëse dhe hapësirave për art dhe kulturë LOT 3" me nr. të prokurimit 616-26-2525-2-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "AK/Komisioni vlerësues UZtë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 1 ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05L-068 dhe Ligjin Nr. 05L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik. AK/zyra e prokurimit me 09.06.2026. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar për kontratë në LOT 3 OE MEGRANT ING SH.P.K. Për lart LOT Oferta e kompanisë sonë ka qenë me çmim më të ulët se çmimi i OE të rekomanduar për kontratë. Pasiqë AK na është drejtuar me leter standarde për tenderuesin e pasuksesshem e jo tenderuesin e eliminuar, citoj: Oferta juaj është vlerësuar si oferte e përgjegjshme në përputhje me kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjen e tenderit, por është e pasuksesshme për shkak se keni ofruar çmim më të lartë, me çmim prej 1575.00euro. Në më 10.06. i kemi drejtuar me email zyres së prokurimit për lartë qeshtë mirepo nuk kemi pranuar përgjigje përse nuk kemi rekomanduar për kontratë dhe në LOT3. Ky konstatim i AK/ komisionit vlerësues nuk qëndron, oferta e kompanisë sonë është 1575.00euro ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë në LOT 3 është 1760.00euro. AK në nenin 2.5 të FDT-së ka cekur se numri maksimal i pjesëve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues është: 2 prandaj kërkojmë nga zyra e prokurimit që të kthejë lenden në ri-vlerësim për LOT 3 dhe të rekomandohet për kontratë kompania jone konform nenit 60 të LPP-së si oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët. Më parasyshfaktet e lartcekura konstatohet se AK/komisioni vlerësues jashtëligjshëm ka rekomanduar për kontratë OE Migrant Ing shpk për LOT3 megjithëse oferta e kompanisë sonë ka qenë me çmim më të ulët".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues në letrën standarde të parashtruesit janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar

si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. Të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 29.06.2026. ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0428 ndërsa me datë 10.06.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0428, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e “INFINITT ” SH.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0428 ka vlerësuar si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Pretendimi nr. 1

Pretendimi i parë dhe kryesor sipas ankesës 428/26 ka të bëjë me arsyen e shpalljes të pasuksesshëm të OE ankues për Lot.3, ku sipas AK-së oferta e OE ankues për Lot.3 ka ofruar çmim më të lartë prej 1,575.00 €.

OE ankues, ndër të tjera, pretendon se:

“Pasiqë AK na është drejtuar me letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm e jo tenderuesin e eliminuar, citoj:

Oferta juaj është vlerësuar si ofertë e përgjegjshme në përputhje me kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjen e tenderit, por është e pasuksesshme për shkak se keni ofruar çmim më të lartë, me çmim prej 1575.00 euro.

Ky konstatim i AK/Komisionit Vlerësues nuk qëndron, oferta e kompanisë sonë është 1575.00 euro, ndërsa oferta e OE të rekomanduar për kontratë në Lot.3 është 1760.00 euro.

AK në nenin 2.5 të FDT-së ka cekur se numri maksimal i pjesëve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues është: 2, prandaj kemi kërkuar nga Zyra e Prokurimit që të kthejë lëndën në rivlerësim edhe për Lot.3 dhe të rekomandohet për kontratë kompania jonë, konform nenit 60 të LPP-së, si oferta e përgjegjshme me çmimin më të ulët.

Ne më 10.06. i jemi drejtuar me email Zyrës së Prokurimit duke kërkuar sqarim pse nuk jemi rekomanduar për kontratë në Lot.3, pasi që AK na është drejtuar me letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm e jo tenderuesin e eliminuar, mirëpo nuk kemi pranuar përgjigje nga Zyra e Prokurimit, prandaj jemi detyruar të parashetrojmë kërkesë për rishqyrtim.

Në përgjigje/refuzim të kërkesës për rishqyrtim është cekur:

Është gjetur se arsyet e evidentuara nga Komisioni Vlerësues në letrën standarde janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht, është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Ky konstatim në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim bie në kundërshtim me njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku AK na është drejtuar me letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm e jo tenderuesin e eliminuar.

Shkelje tjetër procedurale në këtë aktivitet të prokurimit është se AK nuk ka pezulluar aktivitetin e prokurimit, konform pikës 2 të nenit 108/A të LPP-së, pas dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim, por ka vazhduar me dhënie dhe më 24.06. është publikuar njoftimi për dhënie të kontratës për Lot.3.

Marrë parasysh faktet e lartcekura, konstatojmë se AK/Komisioni Vlerësues jashtëligjshëm ka rekomanduar për kontratë OE Migrant Ing SHPK për Lot.3, megjithëse oferta e kompanisë sonë ka qenë me çmim më të ulët edhe në këtë Lot.”

Pas analizimit të shkresave të lëndës, ofertave të OE-ve dhe dosjes së tenderit, kemi gjetur se sipas dosjes së tenderit: “Numri maksimal i pjesëve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues është: 2”.

OE ankues është rekomanduar për kontratë për Lot.2, mirëpo edhe për Lot.3 ka ofruar çmim më të ulët se OE i rekomanduar për kontratë.

Me qenë se sipas dosjes së tenderit OE mund të shpërblehet me 2 lote, atëherë mendimi i ekspertit është që pretendimi ankimor është i bazuar dhe rekomandojmë që lënda për Lot.3 të

kthehet në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “96 Mirembajtja e institucioneve vartese dhe hapësirave për art dhe kulturë” me nr. të prokurimit: "616-26-2525-2-2-1"

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ja fal besimin e plotë raportit të ekspertit, se ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " INFINITT " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: